



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Bordi i FAK") në mbledhjen e vetë të datës 28.08.2017 miratoi këtë rregullore:

RREGULLORE 04/2017

DEFINIMI I OBLIGIMEVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË UDHËHEQËSIT TË EKIPIT NË GARAT NDËRKOMBËTARE

Për të rregulluar dhe lehtësuar organizimin dhe mbarëvajtjen e garave ndërkombëtare si dhe për të siguruar përfundimin brenda afateve të caktuara kohore të gjitha obligimeve si gjatë garës ashtu edhe pas përfundimit të garës, kjo rregullore ka për qëllim që të definoj detyrat kryesore dhe obligimet tjera të udhëheqësit të ekipit.

Neni 1.

Njoftimi për garën

1.1 Kryetari i komisionit të për sportin për të cilin bëhet fjalë dhe disiplinën përkatëse duhet të lajmërojë federatën, kryetarin dhe sekretarin e federatës për planin e garave që planifikojnë të marrin pjesë dhe atë së paku 45 ditë para dates së garës në rastet kur nevojitet vizë hyrëse për vendin ku mbahet gara, dhe 30 ditë nëse nuk ka nevojë për vizë.

Neni 2.

Përgaditja e dokumentacionit për viza

2.1 Në rast se pilotëve Kosovar për hyrje në shtetin ku mbahet gara u nevojitet vizë, atëherë Sekretari i FAK ka për obligim të kërkojë ftesën zyrtare dhe dokumentet përcjellëse nga organizatori i garës dhe duhet të merret me kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e FAK për rregullimin e vizave për pilotë dhe udhëheqësin e ekipit.

Neni 3.

Udhëheqësi i ekipit

3.1 Kryetari i komisionit të për sportin për të cilin bëhet fjalë dhe disiplinën përkatëse propozon udhëheqësin e ekipit për garat ndërkombëtare dhe kërkon aprovim nga kryesia e FAK për propozimin e dhënë.



Federata Aeronautike e Kosovës

Neni 4.

Planifikimi financiar për garën

4.1 Kryetari i komisionit të për sportin për të cilin bëhet fjalë dhe disiplinën përkatëse bashkë me udhëheqesin e ekipit (mund të jetë edhe i njejt) prezantojnë planin financiar për ngjarjen duke përfshirë kalkulimin për çmimin e udhëtimit dhe mënyrën e udhëtimit, shpenzimet e pjesëmarrjes, akomodimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme gjatë tërë periudhës deri në kthim në Kosovë.

Neni 5.

Lajmërimi i rekordit të shënuar, verifikimi dhe zyrtarizimi i rekordit

5.1 Udhëheqësi i ekipit duhet t'i prezantoj paraprakisht kryesisë së FAK mënyrën e sigurimit të fondeve për garën e planifikuar në rast se në atë moment FAK nuk posedon mjete. Pas sigurimit të fondeve ato duhen të deponohen në llogarinë bankare të FAK dhe para nisjes shuma e planifikuar tërhiqet dhe i dorëzohet udhëheqësit të ekipit me dokument pranim/dorëzimi.

Neni 6.

Mbështetja e garës nga ana e FAK

6.1 FAK angazhohet për ndihme teknike dhe financiare vetëm për 10 pilotët më të mirë të rankuar në FAI sipas vendimit 2.1 me 15.03.2017 që është 100% për 5 të parët, 50% për tre të rankuarit mes 6-8 dhe 30% për ata që janë në rangliste 9 dhe 10.

Neni 7.

Komunikimi me organizatorin dhe të tjerët

7.1 Udhëheqësi i ekipit preferohet të mos jetë garues por të ndihmojë të gjithë sportistët për gjitha nevojat e tyre në lidhje me garën, paqartësitë dhe kontaktin me organizatorin, hotelin, transportin etj.

Neni 8.

Pagesat dhe vërtetimet

8.1 Udhëheqësi i ekipit ka obligim që ti ekzekutoj të gjitha pagesat gjatë qëndrimit jashtë vendit dhe të ruaj dëshmitë për pagesë bashkë me faturë fiskale ose në rastet nëse mungon fatura fiskale



Federata Aeronautike e Kosovës

atëhere duhet të jetë letra në word/paragon e nënshkruar dhe e vulosur por e paguar përmes kartelës bankare dhe jo kesh. Në të gjitha fakturat nuk duhet të këte pije alkoolike, në të kundërtën fatura nuk riimburohet nga FAK.

Neni 9. Mbyllja e garës

9.1 Udhëheqësi i ekipit brenda 15 ditëve pas kthimit në vend duhet të dorëzoj tek sekretari apo kryetari këto dokumente:

- a) Faturat origjinale
- b) Raportin e shpenzimeve, me informata për secilën fakturë se për çka është shpenzuar, shumën e paguar në valuten e vendit dhe të konvertuar në euro gjithashtu.

Formati:

Data	Vendi	Vlera	Vlera në Euro	Arsyeja	Numri Faturës
01.01.17	Struge	900 Denar	15 Euro	Ushqim	1
03.01.17	Zagreb	220 Kuna	30 Euro	Nafte	2

- c) Rezultatin e garave
- d) Raportin e përgjithshëm të ngjarjes duke përfshirë gjithë mbarëvajtjen e garës dhe vërejtjet eventuale ose disiplinore ndaj ndonjë piloti

Në rast të vonimit me shumë se 15 ditë kalendarike pas kthimit në vend, rrezikohet që mjetet të mos rimburohen nga MKRS-ja

Neni 10. Hyrja në fuqi

7.1. Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit nga bordi i FAK.

7.2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyre dhe procedurë të njejtë sikur me rastin e miratimit të saj.

Prishtinë, 28.08.2017

Shkelqim Krasniqi
Kryetar i bordit të FAK